



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 19/04/2023 Ref.: 533/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31, nenit 7 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Manualin e Akreditimit (*përditësuar me vendimin Ref.932/22*), Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, mori:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e Kolegjit Dardania në Prishtinë me Nr.prot.360/23 datë 27.03.2023 për tërheqjen e kërkesës për riakreditim institucional.
- II. **Obligohet** Agjencia e Kosovës për Akreditim, të publikoj në ueb faqe raportin me rekomandime të Ekipit të Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë).
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Dardania në Prishtinë ka parashtruar kërkesë me Nr. Lëndë 3522-21 H dhe 441-22 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjit Dardania në Prishtinë me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 20.02.2023, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Drazen Vrhovski, Anca Greere dhe Christopher Bohlens.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegjit Dardania në Prishtinë është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht, zero (0) standarde;
- Substancialisht, dy (2) standarde;
- Pjesërisht, nëntë (9) standarde;
- Nuk i plotëson standardet, zero (0) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 111 të mbajtur më 14.04.2023 ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit Dardania në Prishtinë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër. KShC e ka vlerësuar raportin e Ekipit të Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë) dhe ka konstatuar se është në nivel të lartë profesional dhe në harmoni me standardet e akreditimit të cilat i aplikon AKA. KShC ka shqyrtuar gjithë procesin e vlerësimit institucional në Kolegjin Dardania dhe ka konstatuar se administrata e AKA-së ka zbatuar legjislacionin dhe rregullativën në fuqi.

Në ndërkohë, KShC është informuar nga AKA se ka pranuar një kërkesë nga Kolegji Dardania në Prishtinë me Nr.prot.360/23 datë 27.03.2023 për tërheqjen e kërkesës për riakreditim institucional dhe e njëjta kërkesë është proceduar për shqyrtim në mbledhjen e 111-të Këshillit Shtetëror të Cilësisë mbajtur me datë 14.04.2023.

Kërkesa për tërheqje nga procesi i akreditimit ka ardhur 12 ditë pasi ka ardhur draft raporti i ekspertëve i datës 15.03.2023 dhe katër (4) ditë pas pranimit të raportit final të ekspertëve me datë 23.03.2023.

Kolegji Dardania në Prishtinë ka pranuar draft raportin e ekspertëve ndërkombëtarë më 15.03.2023 dhe ka kthyer komentet për draft raportin, por të cilat kanë qenë jo bindëse dhe për me tepër Ekipi i ekspertëve, të gjeturat i ka argumentuar.

KShC ka shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin e referuar në kërkesë, dhe bazuar në legjislacionin në fuqi (LPPA dhe UA për akreditim) dhe kompetencat që ka, miratohet kërkesën e Kolegjit Dardania, e po ashtu ka obliguar AKA-në që raporti i ekipit vlerësues të publikohet sipas nenit 18 pika 8 e UA për akreditim.

Gjatë shqyrtimit, KShC ka konstatuar se me aprovimin e kësaj kërkesë Kolegji Dardania ka shfrytëzuar të drejtën për të ju nënshtruar procesit të vlerësimit të përcaktuar sipas nenit 11 të UA për Akreditim dhe rrjedhimisht është përmbyllur cikli një (1) vjeçar për të ju nënshtruar këtij procesi.

Bazuar në faktet e prezantuara dhe kompetencat ligjore KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrorë ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.*

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegjit Dardania në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë